



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-117

Prishtinë, më 1 korrik 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 1 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 qershor 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 qershor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 qershor 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

a) Vazhdimi i seancës plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 27 qershor 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet më 11 korrik 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,*
2. *Votimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012,*
3. *Votimi i propozimit të Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar 'ZB' për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.*

b) Përgatitjet për seancën e rregullt

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet më 11 korrik 2013, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Rekomandimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për procedimin e Projektligjit për transplantimin e organeve

Rekomandimin e Komisionit të lartshënuar, Kryesia e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

2. Informatë për gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesia, çështjen e lartcekur e shtyu për mbledhjen e radhës, me qëllim të analizimit të raportit të Komisionit për konstatimin e gjendjes në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi dhe përgatitjes së një rekomandimi për mbledhjen plenare të radhës.

3. Njoftimi i deputeteve Safete Hadërgjonaj dhe Valbona Dibra nga vizita e realizuar në Konferencën rajonale në Mal të Zi, më 1 dhe 2 qershor 2013.

Kryesia u njoftua me vizitën e deputeteve të lartpërmendura, të realizuar në Konferencën rajonale në Mal të Zi, prej datës 1-2 qershor 2013.

Pikat shtesë:

1. Raporti përfundimtar i Komisionit Hetimor Parlamentar

Kryesia kërkoi që raporti i lartshënuar fillimisht t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit dhe i njëjti të radhitet në rend të ditës për mbledhjen plenare.

2. Kërkesa e deputetit Kurtan Kajtazi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit

Kryesia kërkesën e lartshënuar e shtyu për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

3. Rekomandimi i Komisionit për Legjislacion për procedimin e Projektligjit për amnistinë

Kryesia, pasi konstatoi se Komisioni për Legjislacion është duke e shqyrtuar Projektligjin për amnistinë, vendosi që nëse ky komision e procedon raportin për këtë projektligj, i njëjti të radhitet për mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale